



Co-funded by
the European Union



Ndikimi social i zgjedhjeve konsumatore

Mbështetja e punës së ndershme



Kur blejmë produkte nga kompani që respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe ofrojnë paga të drejta, ndihmojmë në përmirësimin e jetës së miliona punëtorëve në botë. Zgjidh produkte me certifikime si: Fair Trade, BSCI, SA8000

Ndalimi i shfrytëzimit të fëmijëve



Shumë produkte të lira mund të jenë prodhuar përmes punës së detyruar apo punës së fëmijëve. Të informohesh dhe të zgjedhësh me kujdes ndihmon në luftimin e këtij fenomeni.

Mbështetja e prodhuesve lokalë



Kur blejmë produkte lokale, përkrahim komunitetin tonë, krijojmë vende pune dhe ulim ndotjen nga transporti i gjatë.

Konsumi i qëndrueshëm dhe i drejtë



- Zgjidh produkte të riciklueshme ose të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme
- Përdor më pak plastikë
- Bli më pak, por më cilësore
- Riparo, riciklo, dhuro

Si të bëhesh konsumator i përgjegjshëm?

- Hulumto para se të blesh
- Pyes veten: A më duhet vërtet?
- Mbështet markat që veprojnë me përgjegjësi
- Ndaj informacionin me të tjerët

Zgjedhjet tona, sado të vogla, janë fuqi për ndryshim. Konsumatorët kanë një zë – le ta përdorim për të ndërtuar një botë më të drejtë, më të barabartë dhe më të qëndrueshme.

Çdo euro që shpenzon është një votë për llojin e botës që dëshiron të ndërtosh.”

Nga konsumi te ndryshimi

Shembuj të ndikimit real të zgjedhjeve konsumatore

- Industria e tekstileve (modës së shpejtë)
- Kompanitë e modës së shpejtë prodhojnë sasi të



i të mëdha veshjesh me kosto të ulët dhe cilësi të dobët.

- Shumë fabrika që prodhojnë për këto marka ofrojnë paga minimale, orë të gjata dhe punë në kushte jo të sigurta.

✓ Zgjidhja: Mbështet markat që ofrojnë transparencë në zinxhirin e prodhimit dhe përdorin materiale të riciklueshme ose organike.

Financuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajë përgjegjësi për ato.

Thirrje për veprim

Ushqimet e përditshme

- Shumë fruta, kafe apo çokollatë prodhohen në vende ku fermerët paguhen shumë pak.
- Agrokultura intensive ndikon në shpyllëzimin dhe ndotjen e ujërave.

✓ Zgjidhja: Zgjidh produkte me etiketim Fair Trade, bio, ose të prodhuara lokal.

Si mund të fillosh ti?

1. Lexo etiketat – Ku është prodhuar? Ka certifikim etik?
2. Blej më pak, por më mirë – Cilësia zgjat më shumë.
3. Rikonsidero zakonet e tua – A ka alternativa më të përgjegjshme?
4. Ripërdor, riciklo, dhuro – Jepu jetës së dytë sendeve që nuk përdor.
5. Bëhu shembull për të tjerët – Ndaj informacion dhe frymëzim.

Arsimi dhe ndërgjegjësimi janë çelësi

- Zhvillimi i një kulture konsumi të përgjegjshëm kërkon:
- Edukim që fillon që në shkollë.
- Media që promovojnë sjellje të shëndetshme sociale dhe mjedisore.
- Dialog mes qytetarëve dhe bizneseve për t'i kërkuar përgjegjësi.

Zgjedhjet tona kanë pasoja që nuk i shohim menjëherë

Në vendet në zhvillim:

- Shumë produkte që importojmë prodhohen në vendet e varfra ku mungon mbrojtja e punëtorëve.
 - Punëtorët, përfshirë gra dhe fëmijë, shpesh punojnë në kushte të rënda dhe me paga minimale.
2. Në mjedis:
 - Konsumi i tepërt çon në ndotje të ajrit, ujit dhe tokës.
 - Prodhimi masiv kërkon burime të mëdha natyrore dhe krijon mbetje të shumta.
 3. Në kulturën tonë sociale:
 - Konsumi i paarsyeshëm forcon një kulturë të mbivlerësimit të pasurisë materiale.
 - Promovon sjellje egoiste dhe ul ndjeshmërinë ndaj pasojave globale.



Konsumi si akt social dhe moral

A e dimë vërtet se çfarë po blejmë?

- Shumë shpesh, konsumatorët blejnë për arsye praktike, estetike ose emocionale – pa e kuptuar zinxhirin kompleks që fshihet pas një produkti. Por çdo produkt ka një histori: kush e ka prodhuar, në çfarë kushte, me çfarë ndikimi në mjedis, dhe si ndikon në komunitetet që e kanë krijuar.
- Prandaj, konsumi nuk është thjesht një akt ekonomik, por edhe moral dhe social.